



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 prill 2021
Nr. ref.: RK1762/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI101/20

Parashtrues

Shqipërim Ademaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Drejtësisë nr.
15/2020, të 21 shkurtit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shqipërim Ademaj, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Kemajl Ademaj, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Vendimit të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: MD), nr. 15/2020 të 21 shkurtit 2020, lidhur me anulimin e provimit të Noterisë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Qeverisë, referuar më lart, përmes së cilit parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet: 7 [Vlerat], 10 [Ekonomia], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat të Njeriut], 99 [Procedurat], 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenet 14 [Ndalimi i diskriminimit] dhe 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Postën e Kosovës. Më 25 qershor 2020, kërkesa arriti në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 korrik 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 3 gusht 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës KI101/20. Një kopje e kërkesës iu dërgua MD-së në pajtim me ligjin.
8. Më 11 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi dokumentacion mbështetës.
9. Më 12 prill 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 19 prill 2019, MD, përmes Vendimit nr. 16/2019, shpalli konkursin publik për kandidatët të cilët dëshironin t'i nënshtroheshin provimit të Noterisë.
11. Më 15 dhe 16 qershor 2019, u mbajt provimi me shkrim për Noterinë, ndërsa më 6, 7 dhe 8 korrik u mbajt provimi me gojë për Noterinë.
12. Më 12 korrik 2019, MD-ja shpalli rezultatet e kandidatëve të suksesshëm të cilët kaluan provimin e Noterisë. Në mesin e tyre ishte edhe parashtruesi i kërkesës, i renditur i 150-ti në listë, të cilit po të njëjtën ditë iu nda Certifikata nr. 150/2019, si dëshmi e dhënies së provimit.
13. Më 22 korrik 2019, MD mori Vendim [nr. 122/2019] për shpalljen e konkursit publik për pranimin e 79 pozitave të lira për noterë në disa komuna të Republikës së Kosovës. Afati i fundit për aplikim ishte 7 gushti 2019.
14. Më 24 korrik 2019, MD e shpalli konkursin publik për pranimin e noterëve.
15. Më 6 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në MD, përmes së cilës kërkoi: *"... Me këtë kërkesë i drejtohem Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës-Komisionit për emërimin e noterëve, sipas konkursit të publikuar nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës, konform vendimit Nr. 122/2019 të datës 22.07.2019. Pasi që kam kaluar provimin e noterisë dhe plotësoj të gjitha kushtet e parapara me ligj për ushtrimin e detyrës së noterit, me këtë kërkesë shpreh interesimin tim për emërim, përkatësisht hapjen e zyrës noteriale në komunat si në vijim: 1. Ferizaj, 2. Lipjan dhe 3. Shtërpçë.(...)"*
16. Më 21 shkurt 2020, MD përmes Vendimit nr. 15/2020 anuloi procesin e provimit të Noterisë të shpallur më 19 prill 2019, për shkak të pretendimeve për parregullsi të procesit, se ka pasur favorizime të familjareve, miqve dhe partiakëve të figurave publike. Pjesa e dispozitivit të këtij vendimi thekson: *1. Anulohet procesi i Provimit për Noterinë, shpallur më datë 19 prill 2019, nga Ministria e Drejtësisë. 2. Të gjitha pagesat e realizuara nga kandidatët që i janë nënshtruar provimit për noterinë sipas pikës 1, të këtij vendimi do të kthehen. 3. Obligohet Departamenti i Profesioneve të Lira dhe Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi, 4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit. Këshilla juridike udhëzon që kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt admirativ pranë gjykatës kompetente.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Vendimin e kontestuar të MD-së i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet 7, 10, 24, 31, 53, 99 dhe 119 të Kushtetutës, si dhe nenet 14 dhe 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së

i. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës

18. Parashtruesi i kërkesës përkitazi me këtë shkelje pretendon se Qeveria, respektivisht MD-ja në mënyrë arbitrare ia ka mohuar atij të drejtat e fituara, duke e trajtuar në mënyrë të pabarabartë para ligjit. Me këtë veprim parashtruesi i kërkesës pretendon se MD ia cenoit të drejtat e njeriut, *"...duke u shmangur nga parimi që qeverisja e Republikës së Kosovës e bazuar në respektimin e të drejtave të qytetarëve të saj si dhe detyrimin për të respektuar të drejtat e fituara"*.

ii. *Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 10 [Ekonomia] të Kushtetutës*

19. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se, MD-ja ka shkelur: *Lirinë e ndërmarrsisë, duke mohuar personave të cilët kanë kaluar provimin e noterisë për të zhvilluar ndërmarrësinë për interesin e tyre, të familjeve të tyre dhe publikut në përgjithësi; Lirinë e konsumatorëve duke ju pamundësuar Lirinë e konsumatorëve, duke ju pamundësuar konsumatorëve ofrimin e një tregu më të gjerë të shërbimeve të noterisë, me qëllim të krijimit të mundësive që shërbimet e noterisë të ofrohen me çmime konkurrencte dhe kualitet me të lartë; Lirinë e ofrimit të shërbimeve për personat të cilët kanë kaluar provimin e noterisë; Lirinë e pronës private, kur personat e përmendur do duke ofruar shërbimet për të cilat janë kualifikuar do të krijonin të ardhura për veten e tyre dhe familjet e tyre dhe gjithashtu do të gjeneronin mjete edhe për shtetin; Lirinë e formimit të çmimeve të shërbimeve në favor të konsumatorëve shërbimeve sipas kërkesës dhe ofertës normale, duke ofruar një ofertë më të gjerë për konsumatorët, me çmime konkurrencte dhe kualitet më të lartë dhe gjithashtu, Ministria me këtë veprim, ka cenuar qasjen e lirë në treg për konsumatorët dhe konkurrencën e lirë. Kjo, kur është i njohur fakti se sipas Ligjit të Noterisë, në Republikën e Kosovës, numri i noterëve duhet të jetë një (1) noter në çdo 10.000 banor, kurse aktualisht në Kosovë, punojnë rreth 70-75 noter, e që 10-15 nga ta duhet të pensionohen deri në fundin e këtij viti. Është për t'u analizuar fakti, se në interes të kujt është ky monopolizim i këtij shërbimi aq të nevojshëm për qytetarët dhe bizneset në Republikën e Kosovës? Një gjë është shumë e sigurt, se; kjo situatë dhe ky monopol i krijuar që tani e tetë (8) vite, qytetarëve dhe bizneseve në Republikën e Kosovës, nuk ju shkon në interes, në asnjë mënyrë"*.

iii. *Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës*

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se MD-ja duke u thirrur në një rivendosje të ligjshmërisë për shkak të shkeljes së dispozitës kushtetuese nga neni 24 i Kushtetutës, *"... u privuan nga e drejta e tyre e fituar, madje jo për faktin se u dëshmua se i njëjti kishte orientim të caktuar politik ose i përkiste grupit të caktuar (edhe pse as kjo nuk do të ishte bazë juridike për cenimin e të drejtave të fituara), por kjo e drejtë të njëjtit ju mohua për të vetmen "arsye", se; Ai, të drejtën e mohuar-anuluar, e kishte fituar në kohën kur Ministria e Drejtësisë, udhëhiqej nga një grupacion tjetër politik, e jo nga grupacioni politik të cilit i takonte personi i cili gjendej në krye të Ministrisë së Drejtësisë, në momentin e dhënies së vendimit të përmendur! Si rrjedhojë e kësaj, paraqitësin e kësaj kërkesë shtrojnë pyetjen se; cili është ose cili mund të konsiderohet faji, lëshimi ose bashkëveprimi i tij, çfarëdo qoftë ai në rastin konkret, për t'ju anuluar e drejta e fituar? Dhe nëse nuk shpallet si kundërkushtetues vendimit*

të përmendur; Cili do të ishte motivi i paraqitësit të kësaj kërkesë dhe të tjerëve për t'ju nënshtruar çfarëdo procesi tjetër eventual për të arritur të drejtën e cila ju ka mohuar apo certifikatën e cila për shkak të anulimit të procesit, gjithashtu konsiderohet e anuluar? Pra, kush mund ta garantoj paraqitësin e kësaj kërkesë dhe të tjerët që nëse i nënshtrohen një procesi të kualifikimit "korrekt" siç ka pretenduar Ministria, se në të ardhmen, qeveria tjetër të mos e vazhdoj praktikën tani më të filluar nga kjo ministri, për anulimin në mënyrë stihike dhe arbitrare të të gjitha veprimeve dhe të drejtave të fituara, në cilëndo qeveri pararendëse. Besojmë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vendimet e tilla në kundërshtim me ligjin, Kushtetutën dhe sigurinë juridike, nuk do t'i lejojë dhe do ta ndërprejë një praktikë të tillë të rrënimit të sigurisë juridike”.

iv. *Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës*

21. Parashtruesi i kërkesës përkitazi me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë shton: “Nga një vlerësim neutral i vendimit të Ministrisë, qartazi rezulton se paraqitësit të kësaj kërkesë ju është mohuar e drejta e fituar, në kundërshtim me të gjitha ligjet vendore dhe ndërkombëtare, duke u shkelë nga Ministria në mënyrë flagrante, parimet themelore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si: 1. Parimi i ligjshmërisë, nenin 4, par.2 të LPPA-së,...2. Parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, neni 6 i LPPA-së,...3. Parimin e objektivitetit dhe paanësisë, neni 7 par.2,...4. Parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, neni 8 par 1, i LPPA-së,... 5. Parimin e administratës së hapur, nenin 9, par. 1 dhe 2, i LPPA-së. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se: “Vendimi i përmendur përmban lëshime në kuptim të nenit 48 të LPPA-së. Kjo për faktin se arsyetimi i vendimit, nuk përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi. Janë tejet të pabesueshme "faktet", për të cilat Ministria pretendon të kenë qenë vendimtare në rastin konkret. Si rrjedhojë, Ministria në vendimin e përmendur, në mënyrë tejet subjektive, qëllimkeqe-me keqbesim dhe në mënyrë tejet sipërfaqësore vetëm "sa për sy e faqe" ka vlerësuar provat të cilat në fakt nuk qëndrojnë”. ... Për më tepër, Ministria, duke u thirrur në nenin 55 të LPPA-së i cili flet për të drejtën e organit administrativ për anulimin e një akti administrativ, në fakt Ministria sipas vendimit ka anuluar jo një akt administrativ individual ose të përgjithshëm por, ka anuluar një proces” Vendimi përmban shkelje nga neni 91 i LPPA-së, për faktin se palës tani paraqitësit të kërkesës, asnjëherë nuk i është dhënë e drejta që të njihet me dokumentet e dosjes së procedurës administrative e cila i ka paraprirë vendimit të atakuar, dhe as nuk i është dhënë mundësia që të marr një kopje të dokumenteve që gjenden në shkresa të lëndës. Gjithashtu, në kundërshtim me nenet 94 dhe 95 të LPPA-së, palës-tani paraqitësit të kësaj kërkesë, nuk i është dhënë mundësia e as e drejta për të paraqitur mendime, shpjegime dhe prova, e as e drejta për t'u dëgjuar në procedurë. Pala tani paraqitësi i kërkesës, asnjëherë nuk u njoftua nga Ministria me aktin administrativ, ashtu siç ka paraparë dispozita ligjore nga neni 110,112 dhe 116, i LPPA-së”.

v. *Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës*

22. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me këtë pretendim thekson se: “Me veprimin si më lart, është shkelur dhe neni 49 i Kushtetutës, sipas të cilit; E drejta e punës garantohet dhe secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës, ashtu siç këto të drejta i proklamonte edhe Deklarata Universale, e cila po ashtu, e garantonte të drejtën për kushte të ndershme dhe të kënaqshme të punës, të drejtën për mbrojtje nga papunësia, të drejta këto të njohura edhe nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i vitit 1996 dhe Karta Sociale Evropiane. Me veprimin e tillë, Ministria, paraqitësit të kësaj kërkesë si një kuadër i ri në moshën 27 vjeçare, me fakultet juridik të kryer dhe me një përvojë pune prej tani pesë (5) vite në njërin nga zyrtat noteriale në Kosovë, padrejtësisht ja ka pamundësuar punën në profesionin për të cilin ka investuar dhe është përgatitur tani e dhjetë (10) vite pa ndërprerë”.

vi. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës

23. Përkitazi me këtë shkelje parashtruesi arsyeton: “Nuk do shumë shpjegim se anulimi dhe mohimi i të drejtave të fituara të individit si në rastin konkret, anulimi i vendimeve të organeve shtetërore-qeveritare mbi baza ideologjike, shkakton pasiguri juridike lidhur me të drejtat e arritura për secilin qytetar. Madje, veprimet e tilla, dekurajojnë qytetarët edhe për të bërë çdo përpjekje për të arritur të drejta të caktuara, ngase një logjikë e tillë pas vetes bartë frikën për anulimin dhe mohimin e çdo të drejte të fituar, gjë e cila edhe vet jetën e qytetareve dhe sidomos të të rinjve, e bënë të pasigurtë dhe tejet të pa perspektivë”.

vii. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 99 [Procedurat] të Kushtetutës

24. Përkitazi me këtë pretendim parashtruesi i kërkesës mëton se: “... shkelur edhe neni 99 të Kushtetutës, sipas të cilit, mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Qeveri rregullohen me ligj dhe rregullore. Kjo për faktin se, me vendimin e përmendur nuk janë përfillur as ligji e as rregulloret relevante, por vendimi është marrë mbi bazën e inateve ideologjike, si një nga shumë veprimet tjera shkarkuese, mohuese dhe anuluese të Ministrisë përkatëse të marrura gjatë kohës sa ishte në pushtet-tani qeveria e shkarkuar”.

viii. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës

25. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 119 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson: “Me vendimin e përmendur është shkelur edhe neni 119 i Kushtetutës, sipas të cilit ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Me këtë veprim, Ministria ka shpërfaqur qëndrimin, diametralisht të kundërt për një mjedis ligjor për tregti dhe ndërmarrësinë e lirë. Kështu duke promovuar politika me të cilat haptazi kufizohet konkurrenca e lirë, mundëson krijimi dhe keqpërdorimi i pozitës monopolistike ose dominuese, të krijuar tani me gati një dekadë në lëmin e noterisë në Kosovë. Me këtë vendim, Ministria ka bërë që konsumi i

shërbimeve të noterisë të mos jetë i kontrolluar nga tregu, kurse mungesa e konkurrencës mes ofruesve të shërbimeve të noterisë, gjithashtu negativisht të përcillet në përmirësimin e cilësisë dhe uljen e çmimit”.

ix. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 14 të KEDNj-së

26. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Me vendimin e atakuar është shkelur rëndë edhe neni 14 i KEDNj-së. Kjo për faktin se, paraqitësi i kësaj kërkesë u diskriminua, përkatësisht ju mohua e drejta e fituar, madje jo për faktin se ai kishte oponent i ndonjë partie të caktuar politike (edhe pse konventa mbrojtëse të drejtat e individëve, duke e konsideruar diversitetin politik si vlerë të demokracisë), por për të vetmin fakt, përkatësisht për faktin se të drejtën e tij e kishte fituar në kohën kur Ministria përkatëse udhëhiqej nga pjesëtarë të përkatësisë tjetër politike nga ata të cilët morën vendimin e përmendur. Me një veprim të tillë të Ministrisë, padyshim se u cenua edhe neni 1 i KEDNJ-se, sipas së cilit palët janë të detyruara që të sigurojnë çdo kujt, që ndodhet në juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në titullin e parë të kësaj Konvente, e që si e drejtë nga titulli i parë i Konventës është edhe e drejta për proces të rregullt e përcaktuar në nenin 6, e cila nga të theksuarat më lart, padyshim se parimi i përmendur është shkelur rëndë nga Ministria”.*

x. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së

27. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur dhe e drejta në pronë, duke arsyetuar si në vijim: *“Meqë e drejta e fituar e paraqitësit të kërkesës është e drejtë e cila mund të trajtohet edhe si e drejtë pronësore, Ministria në mënyrë drastike ka shkelur edhe nenin 1, të Protokollit shtojcë të Mbrotjtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe nenin 2 të këtij protokollit i cili garanton të drejtën për arsim. Kjo pasi që me vendimin e përmendur është shkelur edhe neni 19 i Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera pronësore, i cili duke përkufizuar të drejtat e njëllojta me ato pronësore, ndër të tjera ka përcaktuar se; “Dispozitat e këtij kapitulli vlejnë edhe për të drejta të njëllojta në vlera të tjera pasurore, të cilat nuk lidhen për një send, veçanërisht të drejtat e kërkesës dhe pasuria intelektuale, përderisa në këto të drejta sipas natyrës së tyre ato dispozita janë të zbatueshme. “Kjo për faktin se, derisa paraqitësi i kërkesës, ishte përcaktuar të arrijë të drejtën e fituar në një proces të organizuar nga organet shtetërore në një shtet juridik dhe të së drejtës siç paditësi pretendon, shpreson dhe dëshiron të është Republika e Kosovës. Gjithë këto veprime, paraqitësi i kërkesës, i kishte ndërmarrë, i motivuar që të punojë në kuadër të profesionit dhe të sigurojë të mira materiale për veten e tij, për familjen dhe shoqërinë në përgjithësi. Prandaj, me anulimin dhe mohimin e të drejtës së fituar në këtë mënyrë nga ana e Ministrisë, natyrisht se përpos tjerash, i janë cenuar edhe të drejtat pronësore të tij”.*
28. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Sipas Ligjit për Konfliktin Administrativ, pala e pakënaqur me vendimin përfundimtar të Organit Administrativ, ka të drejtë që me padi administrative të iniciojë konfliktin*

administrativ, për të vlerësuar ligjërinë e aktit administrativ. Nga kjo arsye, pala në rastin konkret e ka dorëzuar një padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Administrative. Megjithatë, duhet pas parasysh faktin se procedura në shkallë të parë nuk përfundohet pa kaluar së paku tri vite, si dhe faktin se sipas praktikës gjykata (Departamenti për çështje Administrative) në të shumtën e rasteve nuk vendosë në mënyrë meritore sipas padisë, por vetëm bënë anulimin e aktit administrativ dhe lëndën e kthen në rivendosje, veprim ky i cili përsëri organit administrativ ja jep mundësinë për rivendosje e cila sërish mundë ta refuzoj kërkesën e palës, gjë e cila përsëri palës paditëse i jep të drejtën të iniciojë konfliktin administrativ. Dhe pas përfundimit meritore në shkallë të parë, secila nga palët e pakënaqura ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit-Departamenti për çështje Administrative, praktikë kjo sipas së cilës, pala mund të detyrohet që të mbetet në pritje të zgjidhjes përfundimtare të rastit madje edhe për një dekadë të tërë. Konsiderojmë se këto janë arsye të mjaftueshme për të përfunduar padia e ushtruar në rastin konkret, nuk është mjet efektiv juridik, sipas të cilit palës do t'i mundësohej që në kuadër të afatit të arsyeshëm, ta realizojë përkatësisht rikthejë të drejtën e fituar të sajë, e cila padrejtësisht i është mohuar nga ana e Ministrisë”

29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

I. Të shpallë kërkesën të pranueshme.

II. Të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 24 par.1 të Kushtetutës së Kosovës, nga ana e Qeverisë së Kosovës - Ministria e Drejtësisë me Vendimin nr. 15/2020 të datës 21.02.2020, të protokolluar në Ministrinë e Drejtësisë me nr.01-173, datë 24.02.2020, me të dhe është anuluar procesi i Provimit për Noterinë i shpallur më datë 19 prill 2019, duke ju mohuar pjesëmarrësve në këtë proces të drejtat e fituara.

III. Të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 7, nenit 10, nenit 24 par.1, nenit 31, nenit 49, neni 53 dhe nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, sa i përket procesit të noterisë dhe mohimit të të drejtave të fituara, te paraqitësit të kësaj kërke.

IV. Të shpallë të pavlefshëm dhe me shkelje të dispozitave të përmendura kushtetuese; Vendimin nr.15/2020 të datës 21.02.2020, të protokolluar në Ministrinë e Drejtësisë me nr.01-173, datë 24.02.2020, më të cilin është anuluar procesi i Provimit për Noterinë i shpallur më datë 19 prill 2019 dhe paraqitësit të kësaj kërke t'i njihet përkatësisht t'i rikthehet e drejta e fituar në procesin e Provimit për Noterinë i shpallur më datë 19 prill 2019”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

32. Gjykata po ashtu i i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, që parasheh:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

(...)

“2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

33. Gjykata merr parasysh rregullin 39 (1) (b) [Kriteret e pranueshmërisë], të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“1. Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar.”

[...]

34. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Vendimin e kontestuar të MD-së, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 7, 10, 24, 31, 49, 53, 99 dhe 119 të Kushtetutës, si dhe nenet 14 dhe 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, si rrjedhojë e anulimit të provimit të Noterisë.

35. Gjykata para se të vlerësojë kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, para së gjithash duhet të shqyrtojë nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës i përmbush kriteret e pranueshmërisë, siç kërkohen me dispozitat e lartcekura.
36. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata i referohet standardeve të konsoliduara në lidhje me detyrimin e shterimit të mjeteve efektive juridike, siç janë zhvilluar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj) dhe praktika e Gjykatës. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton paragrafin 7 (fjala e dytë) të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafi 2 të nenit 47 të Ligjit dhe nënregullit (1) në lidhje me shkronjën (b) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dispozita këto të cilat, ndër të tjera, në mënyrë të qartë përcaktojnë detyrimin e parashtruesve të kërkesave për “shterjen e mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.”
37. Për më tepër, kriteret plotësuese sipas të cilave kërkesat e përcaktuara më lart, mund të konsiderohen të plotësuara, janë përcaktuar mirë në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
38. Arsyetimi i kërkesës për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit është t’u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 të Kushtetutës dhe në nenin 13 të KEDNj-së, se rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese (shih, Gjykata Kushtetuese ne rastin KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2016, § 61; rasti nr. KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafi 35; dhe rasti nr. KI94/14, parashtrues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, § 24).
39. Gjykata vazhdimisht ka respektuar parimin e subsidiaritetit, duke konsideruar se të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet që të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurën e rregullt, me qëllim që të parandalojnë shkeljen e Kushtetutës ose, nëse ka, të korrigjojnë shkeljen e tillë të një të drejte themelore. Gjykata ka pohuar më tej se parashtruesit janë përgjegjës kur rastet e tyre përkatëse shpallen të papranueshme nga Gjykata, nëse nuk kanë shfrytëzuar procedurën e rregullt ose nuk kanë raportuar shkelje të Kushtetutës në procedurat e rregullta (shih, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KI89/15, parashtrues *Fatmir Koçi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 marsit 2016, § 35; KI24/16, parashtrues *Avdi Haziri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 nëntorit 2016, § 39; dhe rasti nr. KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, §§ 35-37).

40. Gjykata rithekson se kjo qasje kërkon që para se të drejtohen në Gjykatë, parashtruesit e kërkesës duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale, në procedura administrative ose gjyqësore, në procedurat e rregullta, për të parandaluar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë ose, nëse ka, për të korrigjuar një shkelje të tillë të të drejtave të garantuara me Kushtetutë (shih, Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KI62/16, parashtrues *Bekë Lajçi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2017, §§ 59-60, rasti nr. KI109/15, parashtrues: *Milazim Nrecaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2016, §§ 27-28; KI148/15, parashtrues: *Xhafer Selmani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 prillit 2016, §§ 27-28).
41. Megjithatë, pavarësisht nga parimet e lartpërmendura, rregulli i shterimit, në bazë të praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, zbatohet me një “*shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar*”, duke pasur parasysh kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në parim, detyrimi për të shteruar mjetet juridike është i kufizuar në përdorimin e atyre mjeteve juridike, ekzistenca e të cilave është mjaft e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë; të cilat janë në dispozicion, të arritshme dhe efektive; dhe të cilat janë në gjendje të korrigjojnë drejtpërdrejt shkeljet e supozuara të KEDNj-së (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNj-së, *Demopolous dhe të tjerët kundër Turqisë*, Seksionet: A. Parashtruesat para Gjykatës për shterimin e mjeteve të brendshme juridike dhe B. Shterjen e mjeteve juridike vendore, respektivisht, §§ 50-129; *Ocalan kundër Turqisë*, §§ 63-72; dhe *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, §§ 155-162). Përveç kësaj, një parashtrues nuk mund të konsiderohet se nuk i ka shteruar mjetet juridike nëse ai mund të tregojë, duke ofruar praktikën gjyqësore përkatëse ose ndonjë dëshmi tjetër të përshtatshme, se një mjet juridik në dispozicion të cilin ai nuk e ka shfrytëzuar, do të dështonte (rasti i GjEDNj-së *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, § 156 dhe referencat e përmendura aty).
42. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konfirmon se në pajtueshmëri me këshillën juridike të Vendimit të kontestuar të MD-së, e cila e ka udhëzuar atë që të iniciojë konflikt administrativ, kundër këtij vendimi në gjykatën kompetente, e ka ushtruar këtë mjet juridik edhe është në pritje të një vendimi nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës pretendon se ky mjet juridik i shfrytëzuar nuk është efektiv, sepse fillimisht zgjidhja e çështjes zvarritet me vite dhe se një mjet i tillë nuk mundëson shqyrtimin merititor të çështjes.
43. Gjykata, në lidhje me pretendimin e ngritur të parashtruesit të kërkesës, vlerëson se arsyet e përmendura në kërkesë nuk e bindin Gjykatën, që i njëjti të lirohet nga detyrimi i shterimit të të gjitha mjeteve juridike pranë gjykatave të rregullta. Për më tepër, Gjykata rikujton se ajo vet nuk mund të zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta të përcaktuar me nenin 101.3 të Kushtetutës “*Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit*”. Për më tepër, kur bëhet fjalë për pretendime të shkeljes së të drejtave të njeriut, të garantuara me kapitullin II të Kushtetutës, Gjykata rikujton sërish nenin 53 të Kushtetutës, i cili i detyron gjykatat që interpretimin e të drejtave të njeriut ta bëjnë në harmoni me vendimet dhe praktikën e GjEDNj-së.

44. Në këtë kuptim, Gjykata përsërit se para se parashtruesit e kërkesave t'i drejtohen Gjykatës me kërkesë, ata duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale, në procedura të rregullta administrative ose gjyqësore, për të parandaluar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë ose, nëse ka, për të korrigjuar një shkelje të tillë të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, parandalimi i shkeljeve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së dhe korrigjimi i shkeljeve të mundshme në pajtueshmëri me nenin 101.3 dhe 53 të Kushtetutës, paraprakisht duhet të bëhet nga gjykatat e rregullta dhe jo drejtpërdrejtë nga Gjykata Kushtetuese.
45. Andaj, Gjykata vlerëson se, në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë argument dhe dëshmi se mjeti juridik i shfrytëzuar në dispozicion të tij është i papërshtatshëm dhe joefektiv, në kuptim të dispozitave të sipërcekura të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës (shih, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese: Rasti nr. KI116/14, parashtrues *Fadil Selmanaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 janarit 2015 §§ 45-46 dhe referencat e cituara në atë vendim).
46. Prandaj, për arsyet e përmendura më lart, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e parakohshme dhe nuk i plotëson kriteret për pranueshmëri pasi që parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar mjetet juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës, dhe si e tillë, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme (shih, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KIo7/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2016, § 62, dhe rasti nr. KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, § 38).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 20 dhe nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullat 39 (1) (b) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 12 prill 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi